

VITI XVI, NUMRI 5 / MAJ 2012

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



Happy  
Birthday

# KRIJO KRYEVEPRËN TËNDE



**S**hpesh kam menduar se në qoftë se do të depërtonim në zemrën e çdo njeriu me të cilin takohemi, do të kishte një ndryshim të madh në mënyrën se si e trajtojmë njeri tjetrin. Secili nga ne ka mundësinë të pafund, ose e thënë ndryshe, ka brënda një kryevepër e cila vetëm pret të zbulohet.

Pikërisht shikimi i mundësive brënda diçkaje, është ajo që artist të mëdhenj si Mikelanxhelo janë të aftë ta bëjnë. Skulptura e tij e Davidit, një nga kryeveprat më të mëdha të historisë të artit botëror, sigurisht reflekton këtë aftësi.

Historia e kësaj kryevepre të pabesueshme fillonte disa dekada para se Mikelanxhelo të punonte me të. Dyzet vjet më përpara, shumë artistë të mëdhenj, i kishin vënë syrin këtij guri të madh sa tre burra bashkë, dhe njeri prej tyre madje kishte filluar të gdhente diçka. Por për fat të keq ai e kish dëmtuar shumë, sa shumë mendonin se ai s'vlente më për ndonjë gjë. Ky gur i mrekullueshëm qëndroi për disa dekada i flakur e i braktisur. Ishte për të ardhur keq, që një bllok i tillë mermeri lihej kot. Shumë vet e konsideronin atë një gabim monumental.

Atëhere, djaloshi Mikelanxhelo, që ishte vetëm 26 vjeç erdhi dhe e pa atë. Në fillim edhe ai ashtu si të tjerët më parë, mendoi se guri ishte shumë i ngushtë dhe me shumë të krisura. Por duke e shikuar më thellë, ai pa diçka brënda këtij guri. Brënda atij blloku mermeri të flakur ai pa mundësi që të tjerët nuk i kishin dalluar, ai pa imazhin e forcës dhe të bukurisë që prisnin të shfaqeshin. Mbas dy vjet e gjysëm përpjekje, ky skulptor i ri, zbuloi veprën gjeniale që e gdhendi nga blloku i mermerit të braktisur. Nga ai bllok që të tjerët e kishin parë si me krisa dhe jo të mirë, Mikelanxhelo krijoi një nga kryeveprat më të mëdha botërore.

Ashtu si mermeri i braktisur, edhe ne kemi difekte. Ndoshta kemi humbur beteja. Ndoshta na duket se nuk jemi të përsosur. Por pamvarësisht çfarë mungesash ne mund të ndjejmë se kemi, brënda secilit nga ne ka një kryevepër që vetëm pret të zbulohet.

Po e njëjta gjë është e vërtetë për çdo njeri që na rrethon. Në qoftë se ne shohim me një sy si ai i Mikelanxhelos, pa difektet dhe dobësitë që ne mendojmë se shohim tek të tjerët, ne do të gjejmë vlera të paçmuara dhe mundësi të pafundme tek çdo njeri që takojmë.

Ky është mesazhi që ju kërkoj ta keni parasysh duke parë videon e re „Bushstrokes” (Vijat e penelit). Ju dhe ata që ju rrethojnë keni potenciale të pafundme për sukses si në jetën personale ashtu edhe në biznesin Forever. Unë kam parë transformime të jetës të mijra vetëve që kanë shfrytëzuar këtë rast për ndryshimin e jetës së tyre dhe të të tjerëve. Produktet dhe forma e këtij biznesi janë mjete për ti ndihmuar të tjerët ti shohin këto mundësi që krijojnë madhështi. Unë dëshiroj që këtë video ta shohin të gjithë dhe të kuptojnë idenë e saj.

Çojeni mesazhin e shpresës dhe suksesit të Foreverit tek sa më shumë njerëz dhe i ndihmoni ata të zbulojnë çfarë ofron Foreveri. Unë e di se me kujdesin e dhe punën e duhur, ne mund të ndihmojmë njeri tjetrin që bllokun e pagdhundur të mermerit të jetës tonë ta kthejmë në kryeveprën tonë.

REX MAUGHAN  
I JUJAI PËRGJITHMONË





# Pesëmbëdhjetë vjetori



**E**rdhi çasti që në historinë e Forever Living Products Hungari të festojmë 15 vjetorin e ditlindjes të saj. Një festë vërtet e mrekullueshme, mbasi hedhim sytë nga vitet e shkuara, ku u bëmë lojtarë përcaktues në botën e Foreverit. Por le ta shikojmë si filloi...

Në Dhjetor të vitit 1995 një sipërmarrës nga Debreceni u nis drejt Gjermanisë të mbuluar nga bora dhe filloi sipërmarrjen më të madhe të botës të Foreverit në Europën Lindore. Të faleminderit József Szabó, që nga krishtlindjet e vitit 1995 mban me këmbëngulje flamurin e Foreverit dhe me krenari e ke ngritur atë gjithnjë e më lart. Me një krenari të vecantë na mbush ajo, që ti arrite të gjeje një nga diamantet më të mëdhenj të botës, Miklós Berkicsin, që e do dhe e nderon e gjithë shoqëria e Foreverit. Miki Berkics, skuadra jote është një skuadër diamantësh! Në këtë skuadër vezulloi diamanti i parë i rajonit tonë nga çifti Veronika e Stevan Lomjanski. Me masa njerëzore nuk mund të matet ajo punë e madhe, qëndresa dhe vullneti me të cilin çifti nga Vojvodina ndërjuan rrjetin e tyre dhe udhëheqin Serbinë. Me këtë skuadër të ndritur u bashkua edhe çifti diamant më i shpejtë e me rezultate të pabesueshme Attila dhe Katika Gidofalvi. Tek Miklós Berkics gjetën sponsorin më të mirë të jetës së tyre, krahas mbështetjes dhe një prapavije të tillë të linjës së sipërme si József Szabó dhe menaxheri dopio diamant Rolf Kipp, që i japin shembull gjithë botës në ndëtimin e rrjeteve. Ky shembull është i përkryer për gjithkënd. Kudo, në Hungari, Serbi, Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mali Zi dhe Shqipëri rrjetet ndërtohen sipas udhërrëfyesit të këtyre diamantëve vezullues. Në qoftë se do të jesh i sukseshëm, kërko sponsorin tënd, pyet sponsorin tënd, dhe pyet diamantët.

Edhe unë kam sponsorin tim, një njeri njëqind herë diamant, ai është Rex Maughan, themeluesi, pronari dhe drejtori ipërgjithshëm i Forever Living Products International. Rex, Ti na krijove një mrekulli, dhe na ke bërë që ta përjetojmë këtë mrekulli çdo ditë, çdo orë dhe çdo minutë. Të faleminderit Ty dhe gjithë drejtuesve të Foreverit që na mësuan, na dhanë udhërrëfyesit, që ne të mund të bëheshim pjesë aktive e MREKULLISË që TI krijove!

Faleminderit TY Gregg Maughan, presidenti ynë, që zotëron një vizion të qartë, dhe drejton fuqishëm e me vull perandorinë globale Forever. Faleminderit miqësore për vitet e mrekullueshme që kemi kaluar me TY, Aidan O'Hare, si zëvendës president për Europën, që me këmbëngulje e pa u shmangur asnjë milimetër nga objektivi i caktuar e udhëhoqe Europën dhe në Forever e bëre të madhe.

Ti që bleve për herë të parë xhelin Aloe Vera, që e provove për herë të parë, Ti që more bonusin e parë, mos u mendo por vepro, dhe futu në ato shtigje që diamantët tanë i kthyen në rrugë të shtruarra të forta. Futu në rrugën e diamantëve që të jesh një anëtar i dobishëm i shoqërisë Forever! Në qoftë se rrjetin tënd e ke ndërtuar me ndershmëri, pastër e thjeshtë dhe në mënyrë të sinqertë, atëhere edhe ti do të jesh pjesë e këtij vlerësimi të madh. Në një vlerësim të tillë që sot ndoshta as nuk guxon ta ëndërrosh. Guxo ta ëndërrosh këtë mrekulli, sepse kjo mrekulli ekziston tash prej 15 vjetësh! Ditlindje të lumtur të Foreverit Hungari i uroj çdo pjestari, distributori e blerësi! Përhëndes të gjithë bashkpunëtorët, anëtarët e Klubit të Presidentit, distributorët, që gjatë 15 viteve të kaluara kanë punuar dhe punojnë me durim bashkë me mua!

Përpara Forever!

DR. SÁNDOR MILESZ  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM





Të Shtunën e Madhe të festës së Pashkëve të prillit u bë takimi i Forever Living Hungari dhe e vëndeve të tjera të rajonit. Edhe këtë radhë stadiumi ishte plot: shumë vetë kishin lënë përgjysëm gatimin për pashkët vetëm që të merrnin pjesë në këtë aktivitet.

**T**akimi i hapjes të pranverës filloi me ngjytjen në podium të menaxherëve: prezantohet pararoja. **Ágnes Krizsó** - zafir menaxhere, si figurë kryesore e skenës dhe drejtuese e programit për këtë ditë, drejton pjesmarrësit në këtë program. „Pashkët janë kohë e vetshërbimit, kur rimendojmë vlerat tona bazë dhe kur përsëri ngjallen shpresat. Krahas jetës kjo është një nga dhuratat më të mëdha të zotit. Uroj që edhe për ju të bëhen realitet këto histori, që do të dëgjoni sot këtu. Uroj që të jetë një pikë kthese kjo ditë, që kurrë të mos e harrojmë” – e hap takimin Ágnes Krizsó, pastaj **Dr Sándor Miliesz**- zafir menaxher dhe drejtor i përgjithshëm, ju uron pjesmarrsve gëzuar festën dhe në mënyrë të veçantë falnderon anëtarët e Klubit të Presidentit. „Kemi ardhur këtu që të mësojmë. Këtu mund të mësojmë teknikat e ndërtimit





BUDAPEST 7.4.2012

# Success Day

të biznesit, se si duhet të „shumfishohemi”, të mësojmë marketingun dhe produktet.” Firma kohët e fundit me anë të një pyetësori ka mbledhur mendimet e distributorëve. 100 % e atyre që kanë kthyer përgjigje theksojnë se produktet janë fantastike. „Shumë rreth nesh flasin për krizë, thotë Dr Sándor Milesz, por kjo nuk ka të bëjë me Foreverin, sepse ne këtu jemi një ishull i veçantë, ne përfaqsojmë një vend të veçantë.”

” Këtë e vërtetojnë shifrat, në 2011 Foreveri i Europës arriti një rritje të xhiros me gati 9.5 %.” „Mos u merrni me lajmet, stakoni televizorin! - këshillon drejtori, sepse shumë më i rëndësishë nga lajmet e këqija, është ajo që të jemi më të shëndetshëm, më të pasur, më të gëzuar, të mund të bëjmë një jetë në harmoni”. Kjo në mënyrë të vecantë duhet të shërbejë si shembull për brezat që vijnë, sepse „brezi i ri do ta çojë botën përpara. Objektivi i 2012, do të jetë kërkimi i këtij brezi.”

**Dr. Ottó Kertész** - menaxher, si baba i tre fëmijve, punon edhe për të ardhmen e tyre. Në vitin 2000 filloi ndërtimin e biznesit dhe 9 herë është kualifikuar për marrje pjesë në Rally-in europian. Mjeku konsulent flet për funksionimin e shëndetshëm të organizmit si dhe për lëndët bazë të nevojshme për këtë. Ai flet për rolin e probiotikëve, të proteinave, të vitaminave, për mundësitë e forcimit të imunitetit, për rritjen e rezistencës, për parandalimin e mungesës së tyre. Domethënë për gjithshka që mund të jetë një informacion i dobishëm për gjëndjen e shëndetit të njerzve sot.





**Krisztina Keszthelyi** – menaxhere ndan me dëgjuesit historinë e saj të suksesit. . Megjithse , sikurse na tregon, ajo vetë nuk ishte kurrë e punësuar, por edhe si sipërmarrëse kishte nevojë për diçka, kishte nevojë për burime të ardhurash që varen më pak nga kushtet e tregut. Si burim ju gjet Foreveri, një kohë me familjen vetëm sa kishte konsumuar këto produkte, por në biznes nuk ishte angazhuar. Kur në 2010 kriza preku edhe sipërmarrjen e tyre, u bind, se ka që jetojnë mirë nga niveli i jetesës, por pothuajse nuk kanë kurrfarë kohe të lirë.

Krisztina u flet me besim atyre që janë prezent, sepse edhe për atë pikë kthese ishte pikërisht një Ditë Suksesi, kur ajo vendosi të ndërtojë biznesin e saj. „Më bindën figurat e shquara të Foreverit, forca e leksioneve të tyre, ashtu siç e pranojnë njerzit njeri tjetrin këtu. por sigurisht edhe shifrat: çeqet me vlera të mëdha „

Kanë një praktikë 20 vjeçare , çifti eagle-menaxher, **Dr Péter Bánhegyi – Adrienne Rokonay**, që tani na flasin së bashku për përvojën e tyre në ndërtimin e biznesit. „Gjëja më e rëndësishme në këtë firmë është ajo që je midis më të mirëve” – thotë Dr Péter Bánhegyi. Ne na nxitu edhe ajo që të ishim shembull për fëmijët tanë. Por ka rëndësi edhe për mjedisin, sepse sa më të mirë të jemi aq më të besueshëm bëhemi, megjithse kjo është edhe përgjegjësi. Jemi krenar i përkasim kësaj firme, kësaj mënyre biznesi”. Secili ka forcën e vet shtytëse Adrienn pas një kohe filloi ta shqetsonte „qënia drejtore”. Mua më nxitu programi i fitimit Profit Sharing, udhëtimi në Hawaii, vetura e Foreverit..., tregon ai, dhe sigurisht doja që të bëhesha menaxher „Eagle”. Ta shfrytëzojmë këtë sistem marketingu dhe të bëhemi gjithnjë e më të mirë.” „E pamundura nuk ekziston „ – thekson Dr Péter Bánhegyi.

Pas leksionit falnderohen ata që kanë ngjitur shkallët e kualifikimit.

Disa prej tyre shprehin falnderimin: „ Këtu kemi mbritur me një punë të vazhdueshme dhe me një skuadër shumë të mirë. Suksesi ynë qëndron në atë që kush afrohet pak ne i ofrojmë mundësitë, i ndihmojmë të tjerët. E bëni edhe ju këtë” – propozon **çifti Tanács**. „Gjithmonë kemi qënë krenar për vajzën tonë, nga kjo krenari e filluam ndërtimin e këtij biznesi.. Të rinjë u japim mesazhin: kini besim se mund të bëhet!”- deklarojnë si menaxherë të rinj **çifti Senk**. „Gjithkush të arrijë sa të jetë një shqiponjë e tillë në pronën e tij” – urojnë **András István Csordás dhe Zsuzsanna Tanács**.







Zafir menaxherë rrallë kualifikohen në firmë, megjithatë **Tamás Budai dhe Éva Schwárcz-Budai** në rrugën e përpjekjeve e kanë arritur këtë në një kohë veçanrisht të vështirë. Prandaj është një mbresë e frymëzuese ti shikosh se si lëvizin ndërmjet murit të bashkpunëtorëve të tyre, që të marrin distiktivin, i cili simbolizon vlerësimin e tyre. „Shumë kohë më parë, që kur fillova në Forever e ëndërroja këtë” – pohon Tamás Budai. „Foreveri është jeta ime e dytë dhe të gjithëve ju uroj që të qëndrojnë këtu.” Éva Schwarcz-Budai falnderon gjithë ata që qëndruan pranë tyre, dhe në radhë të parë Judit Sebők. Tamás Budai, pranë vajzës thërret në skenë edhe djalin e madh si dhe sponsorët dhe menaxherët e tij. „Jam shumë krenar për gjithë skuadrën” – thotë ai dhe në fund edhe një premtim: „Ju premtoj se do të ngjit nivelet!”

Edhe **Edit Knisz**, soaring menaxhere, na flet për vështirësitë, sepse sikurse thotë ajo, „në jetën tonë gjithmonë ka pika rënie, por gjithmonë mund të ngrihesh. Me këtë mundësi u njoha në vitin 1998, dhe që nga ajo kohë, jeta ime ka ndryshuar plotësisht. Në qoftë se e shfrytëzojmë mirë këtë mundësi, atëhere mund të ngjitemi në lartësi të mëdha. Rëndësi ka që gjithmonë të dimë për ku shkojmë dhe çfarë duam të arrijmë. Sipas Edit Knisz edhe në krizë ka avantazhe. „Në situata të vështira vendosëm që Foreveri do të jetë siguria jonë. Besoj se funksionon forca tërheqse, ligji jap-marr. Kuptojeni forcën e Foreverit, jetojeni këtë mrekulli, dhe merrni forcë edhe nga kualifikimi i të tjerëve. Kuptoje që jen ë vendin më të mirë në botë.”

István Kása dhe Istvánné Kása janë zafir të vjetër të rajonit, janë anëtar të Klubit të Presidentit, prej 15 vjetësh ndërtojnë







biznesin e tyre. I zu në moshë e pensionit. "Në punë nuk duhet të mendohesh, kjo është një mundësi. „ – thotë **Istvänné Kása**, „që nga larg ndjen erën e veturave të reja”, kjo e tanishmja është vetura e pestë e re. „E shikoj çfarë i mungon njeriut dhe për atë e ndihmoj atë.” – na rrëfen ajo. Raste të tilla janë të rralla. „Tek kushdo ka thesare, çështja është se a jemi në gjëndje ti gjejmë ato. Po të isha 20 vjeçe nuk do të bëja punë tjetër përveç Foreverit. „ – thotë ajo duke perfrazuar fjalët e **Dr Sándor Milesz**.

Një rast i tillë është i rrallë: në këtë Ditë Suksesit titullohen dy zafir menaxherë. Edhe **Hajnalka Senk** plotësoi kushtet e këtij niveli të lartë. Sin e kurorëzim princi fillon festimi i rezultatit të saj: Hajnalka vjen deri në skenë me një veturë lluksi.. Nuk flet për rezultatet e saj , por me shfaqje në ekran na prezanton një e nga një menaxherët e saj. Në vënd të teorisë na tregon shembuj konkret: se me çfarë takimesh mund të rritesh si drejtues. „ Është e tërbuar kjo skuadër” – thotë ajo duke i falnderuar ata dhe këshillon: „atë keni filluar çojeni deri në fund. Unë sikur edhe 6 muaj ta kisha lënë, tani nuk do të isha këtu dhe nuk do të kisha kaq miq.” Sikurse tregon Hajnalka, që në vogëli është mësuar ta shpërblenin prindërit, por kurrë pa e eritur. Sipas zafir menaxheres të sapo titulluar me rëndësi kyçe është besimi në vetveten. „Gjej vlerën e vërtetë dhe mëso të vlerësosh veten! Edhe në momentin e fundit mund ta arrish atë që dëshiron të lidhen duart. Unë këtë distiktiv doja ta merrja nga **Rex Maughan**, dhe tani kjo u realizua. Kam arritur të bindem çdo të thotë Forever. Të kuptojmë qëllimet e të tjerëve dhe ti ndihmojmë ata ti arrijnë ato.”





## XHAKETA ME PASQYRA GJETITË ZOTIN

Me rënien e gongut në Ditën e Suksesit të prillit u zhvillua një ankand. Nën goditjen e çekiçit nuk qe ndonjë vlerë dosido, ajo ishte xhaketa me pasqyra e presidentit të FLP Rex Maughan që kishte veshur në Rally-in e Budapestit. Ankandi nisi me 300 Euro, ku nga tribuna e errët u nisën shumë vetë, më në fund gjatë gongut të fundit u pa se fituesi i këtij objekti të çmuar ishte Diamant menaxheri Miklós Berkics. Ai pagoi për të 1000 Euro që do ti marrë organizata bamirëse e FLP me emrin Fondacioni Forever Giving.



### Leksiku i FLP

#### Zafir Menaxher:

Distributor që vepron në nivelin e menaxherit ngjitet si Zafir Menaxher në qoftë se në linjën poshtë tij ka të paktë 9 menaxherë të gjeneratës së parë. Punën e tij, FLP e vlerëson: 1. me një distiktiv ari me 4 gurë të çmuar zafiri, 2. me një udhëtim brënda rajonit me 4 ditë (3 netë) ushqim e fjetje.





Pranvera  
në biznesin tonë  
sjell energji të reja, po  
kështu edhe Dita e parë  
e Suksesit e pranverës  
në Beograd.

# Success Day

**BEOGRAD**

24.3.2012







**D**rejtuesit e programit të Ditës së Suksesit me një stil të ndezur por në mënyrë profesionale drejtuan programin e larmishëm me surpriza të shpeshta. Falnderojmë drejtimin e programit plot energji e dashuri nga **Biljana dhe Slobodan Antonijević**.

Programet e reja, stimuj të rinj, një politikë e përsosur, kualifikime eagle... Për këto e shumë gjëra të tjera dëgjuam nga **Branislav Rajić**, drejtori rajonal i FLP Serbi. „FLP në të shkuarën dhe në të ardhmen është njëlloj, drejtohuni asaj me besim, punoni në të, që të realizoni ëndërrat sa më shpejtë!”

Nga të mirë drejt madhështisë: ky është mesazhi i Foreverit në 2012. Këtë mesazh, bashkë me shumë këshilla të tjera të dobishme na përcolli drejtori i pergjithshëm **Dr Sándor Milesz**. Punë në skuadër, frymë skuadre, pavarisi biznesi, ndërtim tregjesh, ndërtim i rrjetit të bashkpunëtorëve: janë vetm disa nga shëmbujt e shkëputur nga mundësitë e ofruara nga Foreveri.

FLP për më tepër se tre dekada gjëndron në vijën e parë të prodhimit të plotsuesve dietikë, ku pjesën më të madhe e kanë produktet e cilësisë jashtzakonisht të lartë. Deri tani kemi dëgjuar në shumë raste leksione për përqindjet, për përbërësit, për efektin e tyre, por blerësit e kënaqur janë votuesit e gjallë me letrat e tyre të rekomandimit. Një gjë e tillë, që gjithkënd e bind se cilësia e produkteve është e jashtzakonshme, dhe falë kësaj në vijën e parë të botës qëndrojnë FLP dhe distributorët e saj. Edhe një numur mjekësh rekomandojnë produktet e FLP, sikurse kemi dëgjuar edhe gjatë leksioneve. Falnderojmë **Dr.Mirjana Nedić** për drejtimin e lartë të këtij blloku të programit, për rrezatimin optimist, dhe për atë mesazh sipas të cilit konsumatori i kënaqur është metoda më e mirë e marketingut.





Forcat tona jetike do të duhej të mbushej me lëndë jetike, megjithatë për shkak të pakujdesisë tonë dhe të mënyra tonë të jetuarit, enët tona të gjakut janë plot me lëndë helmuese. Çdo ditë jemi të ekspozuar ndaj rrezatimeve, lëndëve artificiale, ëmbësuesve dhe lëndëve shtesë që përmbajnë ushqimet që konsumojmë. Në dy dekadat e fundit edhe aftësia riprodhuese e njeriut ka patur efekt negativ në një masë të madhe. ForeverLiving Products me produktet e saja me përbërës biologjikisht aktiv na jep mundësi që trupin tonë ta ushqejmë me elementë ushqyes të dobishëm, dhe falë këtyre cilësinë e jetës ta ngremë në një nivel më të lartë. Faleminderit **Dr. Boro Vujasin** për leksionin e paharruar!

Nga podiumi i Shtëpisë të Sindikatave përshëndeten supervizorët dhe asistent menaxherët e rinj. Ju urojmë atyre shumë suksese në punën e tyre të mëtejshme. Jemi të sigurtë se në muajt e ardhshëm do ti takojmë ata në shkallë më të larta.

**Marko Milanović** tashmë shumë herë ka treguar talentin e tij në koncertet e tij. Ky njeri me zë të mrekullueshëm, me këngën e tij për disa çaste na shpie në Italinë e magjishme.

„Qëllimi im bazë ishte përmirësimi i cilësisë të jetës time - fillon histrinë e tij menaxheri **Milan Mitrović Pavlović** – dhe mora vendimin më të rëndësishëm të jetës time. Që në fillim duhet të përcaktojmë pse e duam ndryshimin, sepse vetëm kështu mund të ndryshojmë jetën tonë dhe të tjerëve. Plani i marketingut i FLP e bën të lehtë ndryshimin me slloganin: „Pastër dhe Thjeshtë”.

Pengesat mund ti mposhtim me vendosmëri të fortë dhe të palëkundshme, me energji optimiste. Çuditë nuk vijjnë vetvetiu, parakushtet duhet ti krijojmë ne me veprat tona. Gjatë jetës sonë kushedi sa herë me gjëra të tilla







për të cilat as që e kemi patur idenë, se e bëjmë për të arritur qëllimet tona. Forever Living nuk njih kufij, sepse edhe ëndërrat dhe dëshirat tona janë të pakufishme. – Gjatë punës frymëzimi nuk duron përgjigje negative, na jep mesazhin e saj **Milena Petrović** soaring menaxhere.

Klubi i 60 pikëve mbledh ata bashkpunëtorë, që rregullisht tejkalojnë këtë kufij pikësh me rrjetet e tyre jo-menaxheriale. Në Rally-in e sivjetëm Botëror të Hong Kongut mund të shkojnë diamant menaxherët **Veronika dhe Stevan Lomjanski**. Ju urojmë atyre rrugë të mbarë, shumë çaste të bukura me kolegët e ardhur nga të gjitha anët e botë, me elitën e FLP!

Eshte gjë e madhe të mësosh nga më të sukseshmit. Në këtë grup bëjnë pjesë në Serbi Diamant Menaxheri **Stevan Lomjanski**. „Energjia pozitive e biznesit është parakusht i suksesit në një firmë të shkëlqyer, dhe plani i marketingut të FLP e bën të mundur që punën tonë ta vlerësojnë dhe shpërblejnë si duhet. Ne nuk punojmë në Forever, por ne e jetojmë atë.” Diamant Menaxheri na jep mesazhin e sinqertë, se çdo përpjekje e investuar ta jep shpërblimin e duhur dhe kjo është një arsye e mjaftueshme që të nisemi në rrugën e suksesit, ku tashmë në mbarë botën prej tre dekadash kalojnë milona vetë.

Një nga shkallët e rëndësishme të punës sonë është arritja e nivelit të asistent menaxherit. Sado mund të duket gjë e vogël kjo një nga gjërat më të rëndësishme, në të cilën njerzit në Forever ecin edhe më tej. Përhëndesim gjithë asistent menaxherët e rinj me rastin e kualifikimit të tyre!

Takimi më i afërt i bashkpunëtorëve të FLP do të jetë më 26 Maj në Shtëpinë e Sindikatave në Beograd. Ju presim të gjithëve me dashuri!

**Branislav Rajić**  
Drejtor i Forever Living - Serbi



FOREVER 

# SUPER RALLY PHOENIX 2012

16-18 Gusht 2012.

## PIKË KONTAKTI

Për bileta avioni:

Gabriella Pittmann, e-mail: [repjegy@flpseeu.hu](mailto:repjegy@flpseeu.hu)

Organizimi i Super Rally-it (akomodim dhe bileta hrje në Rally): Zsuzsanna Petróczy, e-mail: [flpbudapest@flpseeu.hu](mailto:flpbudapest@flpseeu.hu)

Kualifikimi nuk do të thotë automatikisht pjesmarrje prandaj ju lutemi njoftoni qëllimin e pjesmarrjes jo më vonë se 20 Maj në adresën: [flpbudapest@flpseeu.hu](mailto:flpbudapest@flpseeu.hu)

## VËNDI I TAKIMIT SUPER RALLY

### Phoenix Convention Center

100 North 3rd Street

Phoenix, AZ 85003

<http://www.phoenix.gov/phxpccd.html>

## HOTEL I SUPER RALLY

### Sheraton Phoenix Downtown Hotel

340 North Third Street

Phoenix, AZ 85004

<http://www.visitsheratonphoenix.com/>

ose

### Renaissance Phoenix Downtown

50 East Adams Street

Phoenix, AZ 85004

<http://www.marriott.com/hotels/travel/phxbd-renaissance-phoenix-downtown/>

**1500 cc:** biletë avioni për dy vetë, 4 netë akomodim nga 15 deri 19 Gusht, 2 bileta hyrje në Rally dhe 1 pako Rally.

**1000 cc:** 3 netë akomodim dhe 2 bileta hyrje në Rally


**750 cc:** 1 natë akomodim dhe 2 bileta hyrje në Rally

**500 cc:** 2 bileta hyrje në Rally

**250 cc:** 1 biletë hyrje në Rally

**VENDI I TAKIMIT SILVER POST RALLY: Bellagio Las Vegas**





## **TË KUALIFIKUARIT PËR SUPER & SILVER POST RALLY**

### **12500 cc**

Attila Gidófalvi & Kati Gidófalvi

### **7500 cc**

Miklós Berkics

### **5000 cc**

Ágnes Krizsó

Stevan Lomjanski & Veronika Lomjanski

Terézia Herman

Róbert Varga & Timea Hortobágyi-Varga

Zsolt Leveleki & Anita Leveleki

Sándor Tóth & Edina Vanya

István Halmi & Rita Mikola Halmine

Aranka Vágási & András Kovács

Diána Orosházi

Timoslav Brumec & Andreja Brumec

## **TË KUALIFIKUARUT PËR SUPER RALLY**

### **1500 cc**

Tamás Budai Éva & Schwarz Budai

Tihomir Stilin & Maja Stilin

Vilmos Halomhegyi

Dr. Endre Németh & Lukácsi Ágnés

Zsolt Fekete & Noemi Ruskó

Dr. Katalin Pirkhoffer Serené & Dr. Endre Seres

Anita Utasi

Árpád Kis-Jakob & Ibólya Tóth Kis-jakobné

András Bruckner & Dr. Terézia Samu

Tibor Éliás

Jozefa Zore

Ferenc Tanács & Ferencné Tanács

Éva Keszi Szépné

Marija Buruš & Boško Buruš

Csaba Juhász & Enikő Bezzeg

Géza Varga & Dr. Ilona Juronics Vargáné

Tibor Lopicz & Orsolya Lenkó Lopiczné

Anita Balogh & Tamás Süle

Dragana Janović & Miloš Janović

Dr. László Molnár & Dr. Branka Stantic Molnár

Hajnalka Senk

Zsuzsa Szegfű & Csaba Pinter

Ilona Illyés

Klára Hertelendy

# ZAGREB | 17.3.2012

# Success Day

**D**ita e Suksesit e para e këtij viti në Zagreb u mbajt në hotel Four Roses Panorama. Salla ishte e mbushur plot. Ishte gjë e bukur të shikoje gjithë këta njerëz dhe të dëgjoje thirrjet e gëzuara të bashkpunëtorëve të ardhur nga e gjithë Kroacia. Të shtunën ata ia kushtuan mësuarjes dhe shkëmbimit të përvojës me distributorët e tjerë, me qëllim që të përvetsojnë sa më shumë njohuri të reja apo të rifreskojnë njohuritë e fituara deri tani. Shumë prej tyre kanë ardhur me autobus nga Osjeku, Pozhega, Slavonski Brod, Pula, Rijeka. Kolegët e Zagrebit i pritën ata, të cilët pas një kohe të gjatë bashkpunëtorët nga i gjithë vendi mundën ti prisnin si miq.

E veçanta e kësaj dite ishin drejtuesit e programin, çifti nga Rjeka, **Selma dhe Dario Belac**. Falnderojnë pjesmarrësit dhe me fjalë të pakta na tregojnë se çfarë kanë punë kanë bërë para FLP. Kanë ndërruar disa firma para se të njiheshin me rjetet tona të biznesit. Katër vjet më parë as nuk e imagjinonin që Foreveri do të ndryshonte jetën e tyre dhe që do të bëhej si një punë e përbashkët. U bënë ndërtues rjetesh, u morën me njerzit, gjetën bashkpunëtorë të tillë që donin të punonin, të kishin një jetë më të mirë, të kishin pavarësi materiale, që donin realizimin e endërrave të tyre dhe veçanrisht donin LIRI. Kanë dy fëmijët e tyre dhe një mbesë, Adriana.

Pas kësaj vazhdoi ngjitja në skenë e e menaxherëve, senior menaxherëve, anëtarëve të Klubit të Presidentit. Më të sukseshmit përshëndetën bashkpunëtorët tanë, që të shikojnë se kush i drejton dhe kujt ti drejtohen për këshilla në çfardo momenti.

Pastaj **Dr László Molnár**, drejtor i zyrës të FLP të Kroacisë përshëndeti pjesmarrësit, i njohu me aktualitetet që kishin ndodhur që nga Dita e fundit e Suksesit, që ishte edhe ditëlindja e kësaj zyre. Në fakt shumë gjëra kanë ndodhur, por midis tyre ajo që është më e rëndësishme është tedenca në rritje e xhiros të shitjeve. Duket edhe në këtë Ditë Suksesi, që ka gjithnjë e më shumë pjesmarrës. E rëndësishme është puna në grup, fryma e grupit. Drejtori Molnar foli gjithashtu për Rally-in e Budapestit, ku e ndjemë veten shumë mirë. Nga më të mirët mundëm të mësonim, por atëm kohë edhe të miqësoheshim. Para nesh kemi periudhat e kualifikimit për në





Porec apo për në Amerikë...Do të donim që sa më shumë nga bashkpunëtorët tanë të mund të udhëtonin atje falas dhe të mund të merrnin pjesë në këto aktivitete të jashtzakonshme. Rally Global tani është një risi, por bashkpunëtorët tashmë janë njohur me kushtet. Drejtori Molnár ju uroi suksese të gjithëve në punën e tyre, për ecjen përpara, si dhe për atë që të mësojmë sa më shumë nga ata që ndajnë me ne sekretet e suksesit të tyre dhe që na nxisin të ndjekim rrugën e tyre.

Supervizori **Stjepan Beloša**, bletarritës-bioenergjitik, na spjegoi se sa rëndësi kanë për organizmin tonë produktet e bletës. Megjithatë nuk i ka mbushur të 30-at tashmë është babai i 3 fëmijëve. Nga leksioni i Stjepanit mësojmë shumë për bletët, për familjen e bletës dhe për produktet natyrale. Pastaj Stjepani na prezanton produkte e firmës me bazë mjalti, duke patur parasysh në mënyrë të veçantë për atë se përdorimi i tyre mund të jetë ndihmë për ne Duke patur parasysh profesionin e tij bazë si bletarritës, më në fund ka gjetur ato produkte që mund të gjenden në mënyrë natyrale dhe nga më të pastërtat dhe me efektin e të cilave është shumë i kënaqur. **Drejtori Molnár** tashmë ngjitet në podiumin e Ditës së Suksesit si lektor dhe si një rrejtëndërtues i sukseshëm. Ka arritur nivelin e Senior Menaxherit dhe ka shtrirë dorën për Soaring menaxher. Prezanton formën My FLP Biz. Hap pas hapi nga shfaqja deri në aplikimin fenomenal, ku na jep informacion për gjithshka se si mund ta kryejmë dhe si të punojmë me të. Përmes këtij programi mund të ndjekim deri në detaje punën tonë. Është jashtzakonisht i dobishëm. Zoti Molnár premtoi se në kuadrin e kurseve që zhvillohen, përdorimin e programit My FLP Biz do ta përvetsojmë akoma edhe më mirë.

Si u bëra menaxhere? – kjo ishte tema e **Irena Sušanj**, menaxherja nga Rjeka. Dëgjojmë një leksion jashtzakonisht të pasur me ndjenja, me një ton të ngrohtë dhe prekës. Na duket sikur para syve na kalojnë sekuencat e një filmi, plot me situata të vështira, me batica e zbatice, por me një përfundim të lumtur, ku më në fund heroi ynë kruesor duke kaluar mbi çdo vështirësi, fiton shpërblimin e merituar.



Vijon blloku i argëtimeve. Dy miqtë tanë, yje të shkëlqyer të teatrit, filmit dhe televizionit kroat. **Mila Elegović** dhe **Jasna Palić Picukarić** na bënë të gjithëve për të qeshur. Jasna kishte shkruar një pjesë frymëzuese për FLP që bashkë me Mila na i paraqitën në 20 variante. Çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet në një prezantim. Pastaj me një kandidat imituan bisedën e një menaxheri të FLP. Me frymëzim, në mënyrë argëtuese dhe mësimdhënëse. Kitaristi **Mate Picukarić** luajti disa këngë me një performancë plot ndjenja magjepsëse.

Menaxheri **Zsolt Pölhe** do bashkpunëtorë të përgjegjshëm, që e kuptojnë se FLP është punë. Kërkon motivim dhe mbështetje morale nga familja. Bashkë me bashkshorten Sanja, familja e tyre nga ky muaj me ardhjen e fëmijës së katërt, Franceskës, u bë me 6 anëtarë. Zsolt në bisedën e tij na shpjegon se kur punojmë ndaj kujtdu duhet të jemi të përgjegjshëm. Qëndrimi i papërgjegjshëm në punë çon në mospunë dhe shkaton humbjen e besimit në vetvete. Pra të punojmë me përgjegjësi sepse bashkpunëtorët tanë, shembullin tonë ndjekin dhe ne duhet të jemi shembull si sponsor, dhe bashkpunëtor, si konsumator dhe si anëtar besnik i FLP.

Menaxheri nga Rjeka, **Andrea Žantev** që nga koha e shkollës ka patur ëndërra, por tani po i realizon ato. Herë herë me shumë sukses dhe herë herë me më pak. Gjatë jetës është rrëzuar disa herë, por përsëri është ngritur dhe ka gjetur rrugën e vet. Rezistent e për çdo problem e gjen rrugdaljen. Në këtë rrugë gjeti FLP-në dhe filloi realizimin e ëndërrave më të bukura. Vitin që shkoi me një punë të qëndrueshme mblodhi aq pikë sa mundi të hyjë në Klubin e Presidentit. Në fjalën e tij ai shpjegoi se çdo të thotë të jesh midis më të mirëve të rajonit, si dhe atë kur u bë anëtar i Klubit të Presidentit, si e shikon rolin e vet, sa e motivon kjo gjë, sa forcë i jep, sepse e di që në FLP është në rrugën më të mirë. Mbas kësaj vazhdoi një nga pjesët më interesante dhe më të ndjeshme, kualifikimi i kolegëve tanë, të cilët që nga Dita e fundit e Suksesit janë ngjitur një shkallë më lart, duke u bërë supervisor, asistent menaxher apo menaxher. Përshëndesim gjithashtu të kualifikuarit e rinj të programit stimulues të autovetures, ndërsa distributorët më të sukseshëm të dy muajve të fundit morën gjithashtu shpërblimin e merituar. Një foto e bukur si kujtim, por edhe një motivim i madh për punën e mëtejshme.







FLP përveç produkteve të shkëlqyera ofron edhe mundësi të pakufishme. Këtë na spjegoi në leksionin e saj **Rinalda Iskra**, që rrjetet e saj i ka ndërnuar në Kroaci e Slloveni. Senior menaxherja Rinalda është një personalitet i tillë që me qetësinë dhe bizëqeshjen e saj i magjeps të gjithë. Për shumë kohë mësoi në qetësi, por kur ia përkushtoi veten këtij biznesi, shpejt u bë menaxhere. Motoja e saj është „Kurrë mos u dorëzo!” – ky është rregulli kryesor. Sepse shpesh herë ndeshim çaste të vështira, por nuk lejohet të lëshojmë veten dhe të lëkundemi. Renalda nuk u dorëzua. Duke punuar me durim, duke ndjekur rrugën e saj ajo u bë senior menaxhere dhe u kualifikua për programin stimules të autoveturës, në Slloveni është bërë anëtare e Klubit të Presidentit, dhe me siguri nuk do të qëndrojë me kaq. Ti dëgjojmë këshillat e Rinaldas, ti ndjekim ato dhe me siguri sukcesi nuk do të na mungojë!

Në fund të Ditës së Suksestit, mbajti bisedën e vet Senior menaxheri nga Rjeka **Zlatko Jurović**, i cili bashkë me bashkshorten e vet Sonja, prej 12 vjetësh vazhdon në biznesin e FLP. Përveç një jete më cilësore ajo që ka më shumë rëndësi dhe që e gjetën tek FLP, është LIRIA. Mundësia e një jete të lirë, liria e vetkomandimit të vetes. **Sonja dhe Zlatko** janë në rrugën drejt Soaring menaxherit, objektiv nga i cili i ndan vetëm një distancë e vogël. Zlatko na tregon se puna me durim dhe plot përgjegjisi i ka ngritur ata në atë nivel ku janë sot. Deri tek sukcesi ka bërë një rrugë të gjatë. Njohu mundësitë e FLP, u bë zot i vetvetes, punoi, sponsorizoi, mësoi të tjerët të punojnë. Në fakt nuk është gjë e lehtë të motivosh njerzit. I është dashur të ndesh shumë refuzime e mosbesime, por Zlatko qëndroi deri në fund me guxim dhe durim. Me çdo JO më afër ju afrua objektivit, sepse fitorja shpërblen ata që janë më rezistent dhe jo ata që dorëzohen. Tani ka një skuadër të sukseshme, me njerëz të tillë që dëshirojnë jetën e mirë dhe që duan ta shijojnë jetën.

Dita e Suksestit u mbyll me kualifikimin e asistent supervisorëve, të cilët prisnin me durim çastin e vlerësimit të punës së tyre, me dëshirën që së shpejti edhe ata të na bashkohen si lektorë dhe të ndajnë me ne gëzimet e tyre.

Dita më e afërt e Suksestit do të jetë më 19.5.2012 në Opati, në sallën e konferencave të hotel Ambasador.

**Dr. László Molnár**  
Drejtor Rajonal i FLP Kroaci



## 263 FOREVER PRO 6

Një preparat që nuk cilësohet ilaç por me efekte kurative. Efektet e tij vërtetohen nga të dhënat e literaturës profesionale. Përdorimi i tij është i rekomanduar për paksimin e ankesave dhe të simptomave të urinimit (si urinim i vështirë, me pika, me urinim të shpeshtë natën apo ditën, urinim me dhimbje, mbajtje urine) të shkaktuara nga zmadhimi i prostatës, në qoftë se përjashtohet mundësia e kancerit të prostatit.







# Kualifikohu edhe ti!

## PROGRAMI STIMULUES I VETURËS

- 10.01 (a) Menaxheri i Njohur Aktiv ka të drejtë të marrë pjesë në Programin Stimulues.
- (b) Tre nivelet e programit Stimulues janë:
- 1) Niveli i I-rë: FLP paguan më e shumta 400 Euro çdo muaj, gjatë 36 muajve të njëpasnjëshëm.
  - 2) Niveli i II-të: FLP paguan më e shumta 600 Euro çdo muaj, gjatë 36 muajve të njëpasnjëshëm.
  - 3) Niveli i III-të: FLP paguan më e shumta 800 Euro çdo muaj, gjatë 36 muajve të njëpasnjëshëm.

Për tre muaj të njëpasnjëshëm për të marrë pjesë është e nevojshme sipas tabelës:

Muaji	Niveli I-rë	Niveli II-rë	Niveli III-rë
Pikë (CC) të plota			
1	50	75	100
2	100	150	200
3	150	225	300

- (d) Gjatë periudhës prej 36 muaj, direkt mbas kualifikimit, Menaxheri do të marrë pagesën më të lartë mujore për nivelin e arritur të shitjeve të çdo muaji, me kusht që të ruhet kërkesa për pikët e 3 muajve.
- (e) Nqse sasia totale e pikëve të 3 muajve bie nën nivelin e kërkuar atëhere fitimi stimulues do të llogaritet me 2.66 herë Euro të totalit të pikëve të menaxherit për atë muaj.
- (f) Në qoftë se pikët totale të një menaxheri në një muaj të dhënë bien nën 50 pikë, për atë muaj nuk do të ketë pagesë të stimullit. Në qoftë se në muajt pasardhës pikët e menaxherit që kualifikohet do të rriten në 50 pikë e më tepër, stimuli do ti paguhet në përputhje me rregullin e përcaktuar më sipër.
- (g) Një menaxher që ka 5 menaxherë aktiv të sponsorizuar personalisht gjatë muajit të tretë të kualifikimit, apo në ndonjë muaj të periudhës 36 mujore atëhere kushti 3 mujor do të reduktohet në 110, 175 ose 240 pikë respektivisht sipas niveleve 1, 2 dhe 3.
- (h) Për çdo 5 menaxherë të tjerë të njohur dhe aktivë të sponsorizuar personalisht gjatë muajit të 3-të të kualifikimit, apo çdo muaj tjetër të periudhës 36 mujore, kushti i 3 muajve do të reduktohet akoma me 40, 50 dhe 60 pikë sipas niveleve 1, 2 dhe 3 respektivisht.
- (i) Pikët do të llogariten për kërkesat e kualifikimit dhe të ruajtjes të nivelit vetëm gjatë muajve në të cilët menaxheri është aktiv.
- (j) Pikët e bëra nga një distributor aktiv, para se të kualifikohet menaxheri i njohur, do të llogariten për kualifikimin për stimujt e fituar.
- (k) Pas plotësimit të muajit të tretë të kualifikimit për një stimul të fituar, menaxheri mund të kualifikohet për një stimul më të lartë në çdo kohë duke filluar pikërisht nga muaji tjetër. për shembull në qoftë se një menaxher kualifikohet për nivelin e I-rë në janar, shkurt dhe mars me 50, 100 dhe 150 CC, dhe pastaj në prill siguron 225 pikë, pagesa e periudhës të nivelit të I-rë do të zëvendësohet me një periudhë të re pagese 36 mujore për nivelin e 2-të.
- (l) Në fund të periudhës 36 mujore, menaxheri mund të rikualifikohet për një stimul të ri të fituar, duke shfrytëzuar të njëjtat kualifikime sikurse u përshkruan më sipër. ky rikualifikim mund të plotësohet për një tremujor çfardo (me muaj të njëpasnjëshëm) brënda 6 muajve të fundit të periudhës së parë 36 mujore.



# Mundësinë e fatit

## E KEMI NË DUART TONA

**Sponsor:** Ágnes Krizsó

**Linja e sipërme:** József Szabó, Rolf Kipp, Rex Maughan

**KUSH DO TI NDIHMONTE MË MIRË NJERZIT SE SA NJË ÇIFT MJEK SPORTI, MJEK SPECIALIST I SHËNDETIT, KIRURG-PATHOLOG DHE MJEK FAMILJE? PRA NJË ÇIFT BASHKSHORTËSH MJEK TË FOREVERIT. KATALIN DHE ENDRE NË KËTË „KATEGORI” JANË ZAFIRËT E PARË NË HUNGARI, DJALI TYRE ËSHTË MENAXHERI I NËNTË I TYRE. NA TREGOJNË PËR PËRVOJËN E TYRE 14 VJEÇARE.**

**Profesionin e mjekut shumë vetë nuk e konsiderojnë punë, por profesion. megjithatë ti Endre e le karrierën për Foreverin. A më kuptoni?**

**Endre:** Po, e lashë, sepse kështu mund të ndihmoj më shumë njerëz. Mund të ndikojmë në jetën e tyre, shkurtojmë rrugën e atyre që na ndjekin për tek sukcesi dhe për këtë jemi krenarë.

**Për ju cili qe „butoni”, dmth cila ishte ajo shtytje që filluat?**

**Endre:** Flauta shumë e dashur. Vajza jonë Dóra, që më 1998 ishte 15 vjeçe e gjysëm, në një konkurim botëror u rreshtua e pesta si flautiste midis të rriturve. Kishte talent, këmbëngulje, por nuk kishte instrument profesional. Bashkëshortja kishte shumë besim në suksesin e vajzës dhe për këtë më tha sikur të shisnim shtëpinë që ti blenim vajzës instrumentin e duhur. Por edhe me më shumë aftësim më kot punonim edhe në disa punë të dyta, sepse pagesa jonë nuk mjaftonte edhe sikur 100 vjet të kursenim.

**Kati:** Patëm edhe arsye tjetër. Shëndetsia është një fushë me shumë shkallë hierarkike e me shumë konflikte dhe e shikoja që im shoq nuk e ndjente veten mirë në atë vend pune.

**Endre:** Nuk e gjeta veten në atë vend pune, rezultatet nuk vlerësoheshin, puna jashtë orarit nuk sillte para apo vlerësim dhe besoja se duhet të vendosja midis familjes, shëndetit dhe vlerësimit material. Ndërkohë kërkoni një alternativë dhe në këtë kohë na trokiti mundësia me ndihmën e Ági Krizsó.

**I pe shpejtë këto mundësi?**

**Kati:** Unë nuk gjykoj me të parën, dua që më parë ti provoj gjërat. Por isha e hapur sepse si mjeke gjithmonë kam menduar se një numur sëmundjesh mund të parandalohen më përpara se të provojmë mjekimin e simptomave. Kisha zhvilluar shumë leksione sqaruese për mënyrën e të ushqyerit, për mënyrat e mjekimit natyral dhe vazhdimisht kisha kërkuar se si mund të jepja në dorën e atyre që e duan shëndetin një mjet të tillë me të cilin të mund të parandalonin të keqen problemin.

**Edhe Endre ishte kështu i hapur?**

**Kati:** A, atë mu desh ta bindja me forcë fine, që të paktën takimi i parë prezantues të bëhej në shtëpi.. Pastaj gjatë prezantimit provuam një krem aloe dhe programi deri në fund qe rezultativ. Atëhere e pash për herë të parë tim shoq që u zbut, megjithse nuk firmosi menjëherë.









### Mjaftoi pak krem?

**Endre:** Dalë nga dalë pamë edhe produktet e tjera; cilësia e tyre ishte e mrekullueshme. Raporti i përbërësve në Aloe Vera është ideal, lëndët ushqyese dhe vitaminat forcojnë efektet e njera tjetrës. Në qoftë se ndihmojmë organizmin tonë me forcën e natyrës të arrijmë një gjendje më të mirë, atëherë nis mekanizmi vetmjekues dhe organizmi e merr veten. Vetëm mendoni... sot kemi në dispozicion 15 herë më shumë ilaçe se dy dekada më parë, metoda shumë të mira diagnostikimi, megjithatë nuk jemi më pak të sëmurë. Në fakt një rrugzgjdhje ka: kjo është parandalimi. Megjithatë që ta kuptohej kjo, në radhë të parë mu desh të ndryshoja vetë., që me mish e shpirt ti përvishesha kësaj rruge dhe sot them nuk do të mund të mendoja ndryshe.

### Në këtë mënyrë e le bistrinë...

**Endre:** Doja të bëhesha profesionist. Që dikush të bëhet drejtues, njohja e produkteve ka rëndësi, por të paktën po kaq rëndësi ka edhe ndërtimi i rrjetit. Detyra është e thjeshtë: duhet ndërtuar tek njerzit një vizion të qartë për një jetë të shëndetshme dhe më të mirë dhe duhet të arrihet që edhe të kenë besim tek vetja. Por në botën e sotme kjo nuk është aq e thjeshtë. Por vepron ligji i numurave të mëdha.

**Kati:** Pas nivelit të supervisorit, nivelet e asistent menaxherit dhe të menaxherit i arritëm njëkohsisht brënda një muaji, të dy distiktivat i morëm bashkë. Megjithatë edhe atëherë nuk kishim kuptuar shumë nga e gjithë kjo, por kishim kredibilitetin tonë: në qoftë se thërrisim 40 vetë, 39 vetë ishin prezentë.

### Mbase si mjek e kishit më të lehtë?

**Endre:** Por kjo e bën pikërisht të vështirë. Tashmë e di se vlerësohet jo profesioni ynë origjinal, por personaliteti ynë. Por sigurisht duhet ta pranojmë se në disa qarqe, vërtet ishte më e lehtë për ne të bënim hapat e nevojshme.

**Kati:** Sigurisht kishim edhe xhelozitë tona- sepse nuk ishte e thjeshtë të punonim me kolegët tanë mjekë. Tashmë situata ka ndryshuar pak, sepse edhe mjekësia është bërë më e hapur, sepse studimet i kanë mbështetur rezultatet tona, dhe kështu janë lidhur gjithnjë e më shumë mjekë.

**Endre:** Sukseset erdhën në vazhdimësi, çdo premtim e realizuam. Atë mund të arrinim deri te zafir menaxheri e arritëm, sepse e gjykonim se në qoftë se nuk do ta arrijmë ne, atëherë si mund të presësh rezultate nga të tjerët.

### Për 14 vjet duket se edhe jeta juaj ka ndryshuar.

**Kati:** Si jo. Na u dhanë mundësi të tilla që pa Foreverin as që do ti kishim përjetuar kurrë. Kur erdhi letra e bonusit të parë, as që e besonim se vërtet ishte në llogarinë tonë. Pastaj nuk patëm më ndalesa.

### Si i ndatë detyrat?

**Kati:** Strategjinë gjithmonë e kemi bërë bashkë. Në pikat më të largëta shkon Endre, ndërsa me çështjet lokale merrem unë. Shpesh zhvillojmë trainime, takime dy ditore dhe japim edhe vetë leksione. Pjesën më të madhe të sponsorizimeve e rregullon Bandi, ndërsa unë kjdesem më shumë për blerësit dhe për shtimin e shitjeve. Ndërsa drejtimi i skuadrës është pjesë e punës së përbashkët.

### Cili është sekret i zgjerimit të rrjeteve?

